

Të Mbështesësh Fëmijën tënd Interseks

Krijuar nga IGLYO, OII Europe & EPA



Contents

Hyrje: Çfarë është interseks? **2**

Këshilla për prindërit **4**

Pyetjet më të shpeshta **6**

Marrja e vendimeve në lidhje me ndërhyrjet mjekësore
14

Të flasësh me fëmijën mbi të qenit interseks **18**

Si të bisedosh më të tjerë për fëmijën tuaj
interseks **22**


Pyetje që të tjerët mund të bëjnë **24**

Si të flasim me mësuesit, doktorë dhe profesionistë të
tjerë rreth fëmijës suaj interseks **26**

Fjalorth **30**

Links dhe burime të dobishme **34**

IGLYO, OII Europe & EPA **36**



Hyrje

Çfarë është interseks?

A është djalë apo vajzë? Kjo është pyetja që shtrohet në të gjithë botën kur dikush lind. Shumë prindër do t'i përgjigjen kësaj pyetjeje pa u menduar gjatë. Por për një numër të konsiderueshëm prej tyre përgjigjja do të jetë më komplekse.

Interseks është një term ombrellë që përdoret për të përshkruar një gamë të gjerë të variacioneve natyrore trupore. Individët interseks lindin me karakteristika të seksit (për përkufizime, shiko Fjalorthin, f. 30) që janë ose femërore dhe mashkullore në të njëjtën kohë, ose jo plotësisht femërore apo mashkullore, ose as femërore dhe as mashkullore. Karakteristikat e seksit dhe trupat e personave interseks janë variacione të shëndetshme të seksit njerëzor.

Për disa persona, trupi i tyre interseks është i qartë që prej lindjes, për disa kjo bëhet e qartë gjatë fëmijërisë e për të tjerë trupi i tyre shfaqet si interseks gjatë adoleshencës ose madje edhe në moshë madhore. Për disa, ndryshimet në trupin e tyre do të jenë aq të vogla sa mund të mos e kuptojnë kurrë se janë interseks.

Ka shumë mënyra nëpërmjet të cilave variacione të karakteristikave të seksit mund të përshtahen. Një fëmijë mund të lindë me një klitoris më të madh apo me një penis më të vogël ose në formë ndryshe. Ndonjëherë një fëmijë lind me tipare tipike femërore, por zbulohet se ka teste të brendshme, dhe ndonjëherë një fëmijë me tipare tipike mashkullore zbulohet se ka mitër ose vezore. Në disa raste, një vajzë nuk do të fillojë të menstruojë ose një djalë po. Fëmijë të tjerë mund të kenë një përbërje hormonale që është e ndryshme nga ajo që pritet për një "vajzë" ose "djalë".


Këto lloj variacionesh janë të natyrshme dhe më të zakonshme nga sa ju mund të mendoni. Vlerësohet se të paktën 1 në 200 persona janë interseks dhe disa burime deklarojnë se deri në 1.7% të njerëzve kanë njëfarë variacioni në karakteristika të seksit të tyre.

Karakteristikat e seksit mund të ndahen në karakteristika parësore dhe në karakteristika dytësore të seksit.

Karakteristika parësore të seksit janë të gjitha karakteristikat që janë të pranishme gjatë lindjes. Këto përfshijnë kromozomet, organet gjenitale, sistemet riprodhuese, gonadet dhe sensitivitetin dhe prodhimin hormonal të personit.

Karakteristika dytësore të seksit janë të gjitha karakteristikat që bëhen të dukshme gjatë pubertetit dhe përfshijnë rritjen e gjirit, rritjen e flokëve, menstruacionet, mollën e Adamit, shtatin, masën e muskujve dhe shpërndarjen e yndyrave në trup.

Ky udhëzues është krijuar nga IGLYO, OII Europe dhe EPA. Ai synon të prezantojë këtë temë, të japë këshilla se si ta mbështesni sa më mirë fëmijën tuaj interseks, dhe ku të merrni informacione të mëtejshme. Në tekstin vijues, ne do t'i përdorim "ato/a" (në vend të "ai" ose "ajo") si përemër asnjëanës për të gjithë, duke pranuar plotësisht se ekziston një larmi identitetesh gjinore.***



Këshilla për prindërit

Të zbuloni se fëmija juaj është interseks mund të vijë si surprizë për ju. Ju mund të ndjeni dhe mendoni shumë gjëra si rezultat i këtij lajmi.

Ju mund thjesht të ndjeni gëzim të plotë me lindjen e fëmijës suaj ose mund të filloni të shqetësoheni për mirëqenien e tyre. Juve ju mund të thuhet se fëmija juaj nuk është i shëndetshëm. Ashtu si me fëmijët dhe adoleshentët meshkuj dhe femra, fëmijët dhe adoleshentët interseks mund të përballen me çështje shëndetësore, por kjo nuk përcakton se kush ato/a janë. Para së gjithash, ato/a janë fëmijët tuaj, e si të tillë do t'ju duhet dashuria dhe vëmendjen tuaj, do të qeshin bashkë me ju dhe ndonjëherë do t'ju bëjnë të zemëroheni. Kur të rriten do të bëjnë zgjedhjet e tyre në jetë përsa i përket mënyrës se si do të jenë si njerëz: një dëshmi tjetër e larmisë së natyrës.


Këtu do të gjeni disa këshilla që do t'ju ndihmojnë në përpunimin e informacionit më të cilin do të përballeni dhe do t'ju përgatisin për t'i siguruar fëmijës suaj, ashtu si çdo fëmije tjetër, mbështetjen që do t'i duhet.

Nuk ka asgjë të keqe me fëmijën tuaj

Për shumicën dërrmuese të njerëzve interseks, nuk ka asgjë të keqe fizikisht me ta dhe nuk ka nevojë për ndërhyrje mjekësore. Nëse mjeku juaj ju thotë se trajtimi mjekësor është i nevojshëm, pyetini për ndërlikimet apo implikimet shëndetësore dhe rreziqet që lindin si nga kryerja e këtyre trajtimeve si nga moskryerja e tyre. Më pas, merrni kohën e duhur për të marrë një vendim sa më të informuar. Gjithmonë merrni një mendim të dytë dhe kryeni hulumtimin tuaj.

Nuk është faji juaj

Kur prindërit zbulojnë se ka diçka ndryshe në lidhje me fëmijën e tyre, shpesh një nga mendimet e para është: 'A mos vallë kam bërë diçka gabim?' ose 'A mund ta kisha parandaluar këtë?'. Të kesh një fëmijë interseks është diçka plotësisht e natyrshme dhe nuk vjen si rezultat i diçkaje që ju keni bërë. Nuk ka asnjë arsye për t'u ndjerë të turpëruar.



Nuk ka asgjë të keqe nëse ndiheni konfuz apo të trishtuar.

Kur kemi pritshmëri të caktuara, veçanërisht rreth diçkaje aq të rëndësishme sa të pasurit e një fëmije, është e kuptueshme që ne të përjetojmë emocione të ndryshme kur diçka e papritur ndodh. Të zbuloni se fëmija juaj është interseks mund të bëjë që të ndjeheni të frikësuar, të zemëruar, të mërzitur, të shqetësuar, të turpëruar, fajtor ose një përzjerje e disa apo e të gjitha emocioneve të përmendura më sipër. Shumë nga këto ndjenja janë të shkaktuara nga e panjohura dhe do të pakësohen me kalimin e kohës, ndërsa mësoni më shumë dhe flisni me persona të tjerë rreth çështjes interseks. Mundohuni të mos i shtypni ndjenjat tuaja, edhe nëse ato janë sfiduese. Gjeni njerëz me të cilët mund të bisedoni dhe që mund t'ju ofrojnë mbështetjen që ju nevojitet. Pyesni spitalin ose mjekun tuaj rreth opsioneve që keni përsa i përket marrjes së mbështetjes psikologjike. Kontaktoni në organizatat që merren me çështjet përkatëse për të marrë më shumë këshilla dhe informacion. Nëse është e mundur, bisedoni me familjen ose miqtë tuaj. Ju duhet të kujdeseni për veten tuaj, përndryshe nuk do të jeni në një pozitë të mirë për t'u kujdesur për fëmijën tuaj.

Ju nuk jeni vetëm

Është e lehtë të ndiheni sikur jeni personi i vetëm në botë që po kalon atë që ju po kaloni dhe që askush tjetër nuk do t'ju kuptojë. E vërteta është se ka një numër në rritje të organizatave interseks që mund t'ju ofrojnë informacion, drejtime rreth grupeve mbështetëse (qofshin këto fizike apo në internet), që mund t'ju lidhin me këshillues rreth çështjes interseks apo me prindër të tjerë të fëmijëve interseks. Të biseduarit me persona të tjerë që kanë fëmijë interseks mund t'ju japë më shumë informacion, këshilla dhe mbështetje. Biseda me të tjerët është një hap i rëndësishëm për 'daljen hapur' si një prind i një fëmijë interseks. Mos u ndjeni sikur ky fakt është një sekret që duhet ruajtur, pasi kjo nuk është mirë as për ju e as për fëmijën tuaj. Nëse jetoni në një vend ku ndjeni se të 'dalit hapur' rrezikon sigurinë tuaj dhe të fëmijës suaj, ju inkurajojmë që të lidheni me OII Europe, të cilët mund t'ju ndihmojnë të gjeni prindër të tjerë që janë në një situatë të ngjashme me të cilët mund të flisni.

Nuk është e nevojshme që të keni të gjithë përgjigjet menjëherë

Me kalimin e kohës, ndërsa i tregoni fëmijës tuaj dhe të tjerëve përreth jush, do të përballeni me shumë pyetje. Të gjithë këto pyetje mund t'ju hutojnë dhe mund të krijojnë ndjesinë se brenda natës duhet të bëheni ekspert i kësaj temë. Është në rregull të mos i keni të gjitha përgjigjet menjëherë. Në të njëjtën kohë mos e mënjaroni si temë. Sa më shumë që mësoni dhe diskutoni me të tjerët rreth saj, aq më të përgatitur do të jeni për të mbështetur fëmijën tuaj kur edhe ato/a të fillojnë të kenë pyetjet e tyre.

Pyetjet më të shpeshta

Si do ta kuptoj nëse fëmija im është interseks?

Ju mund ta kuptoni këtë që kur fëmija juaj lind, gjatë pubertetit ose gjatë adoleshencës. Në varësi të variacionit specifik, ka mënyra të ndryshme për ta kuptuar. Ndonjëherë një fëmijë është dukshëm interseks që në momentin e lindjes. Sidoqoftë, nuk është gjithmonë ky rasti pasi mund të kuptoni se fëmija juaj është interseks pas lindjes por edhe më vonë gjatë jetës përmes mjeteve të ndryshme, duke përfshirë këtu:

- Teste të gjakut menjëherë pas lindjes
- Ekzaminime rutinore mjekësore të tilla si sonogramet në abdomenin e fëmijës tuaj
- Operacione rutinë në fëmijëri si riparimi i hernies dhe apendektomisë
- Puberteti i fëmijës suaj mund të jetë i ndryshëm nga ai i bashkëmoshatarëve
- Ndonjëherë mund ta kuptojë që gjatë shtatëzanisë për shkak të kontroleve prenatale.
- Persona të të gjithë grupmoshave mund të zbulojnë se janë interseks.

Fëmija im është interseks. Po tani?

Variacionet ndodhin kudo në natyrë. Të qenët interseks është një prej tyre dhe nuk është asgjë për t'u frikësuar. Një nga gjërat më të rëndësishme është të jesh i hapur me fëmijën tënd (në një moshë të përshtatshme) dhe të dëgjoni me kujdes nevojat e fëmijës suaj. Natyrisht që do të ketë disa sfida gjatë rrugës. Një prej tyre do të jetë fakti që shumica e njerëzve ende nuk dinë shumë për ekzistencën e njerëzve interseks, e për këtë arsye ju duhet të gjeni mënyra për ta prezantuar këtë çështje dhe për të edukuar njerëzit rreth situatës dhe nevojave specifike të fëmijës suaj. Për shembull, për të parandaluar ngacmimin e fëmijës suaj në kopësht apo shkollë duhen gjetur mënyra për të mbështetur, këshilluar apo informuar stafin shkollor.



Prindërit që shprehen hapur tek persona të tjerë për fëmijën e tyre interseks, raportojnë se më së shumti, personat të cilëve u thonë për fëmijën e tyre tregohen mbështetës dhe janë te interesuar të mësojnë më shumë rreth çështjes interseks. Në thelb, ju si prindër, keni në dorë mënyrën sesi të tjerët do ta trajtojnë fëmijën tuaj. Për ju (dhe partnerin tuaj), mund të duhet pak kohë për t'u mësuar me idenë dhe për t'u informuar se çfarë do të thotë të kesh një fëmijë interseks. Jepjani vetes këtë kohë. Në këtë proces mund t'ju kërkohet të merrni disa vendime të vështira, siç është kërkesa për të dhënë pëlqimin tuaj për operacione të pakthyeshme ose procedura të tjera mjekësore, por mbani mend se në çdo rast tjetër, përjashtoj rasteve kur fëmija juaj ka nevojë për kujdes mjekësor urgjent (gjë që ndodh rrallë), duhet të merrni këshilla nga më shumë se një burim dhe duhet të merrni kohën e duhur përpara se të arrini në vendime që kanë pasoja të pakthyeshme.

A duhet të pranoj operacionin para se fëmija im të regjistrohet si mashkull apo femër?

Para, kur, ose pasi të keni regjistruar seksin e fëmijës tuaj, profesionistë mjekësore, familjarë, ose miq mund t'ju këshillojnë të pranoni trajtime mjekësore që ndryshojnë trupin e fëmijës tuaj drejt një pamje të jashtëme në dukje më femërore ose mashkullore*. Sidoqoftë, këto operacione 'normalizuese' mund të jenë shumë traumatike për të përfshirët në to dhe shpesh çojnë në probleme mjekësore përgjatë gjithë jetës së tyre. Argumentet më të zakonshme në mbështetje të ndërhyrjeve të tilla mjekësore përfshijnë:

- Mosoperimi do të rrisë rrezikun e kancerit
- Në mënyrë që fëmija të mos i kujtojë ndërhyrjet, është më mirë ta operoni atë në një moshë shumë të hershme
- Ndërhyrja e hershme është më pak e rrezikshme / më e suksesshme
- Ndërhyrjet do të zvogëlojnë presionet sociale dhe do ta ndihmojnë fëmijën të "përshtatet" më mirë

Para se të jepni pranimin tuaj për çfaredolloj operacioni apo ndërhyrje mjekësore, është e rëndësishme të dini se aktualisht nuk ka prova shkencore që mbështesin argumente të tilla. Kjo do të thotë që askush nuk ka kryer kërkime shkencore për të vërtetuar se operacione të tilla, kanë pasur një ndikim pozitiv te fëmijët dhe të rinjtë që i janë nënshtruar atyre, në krahasim me njerëzit interseks nuk i kanë kryer ato.

Pyesni veten: a do të kishit dashur që prindërit tuaj të marrin një vendim që është i pakthyeshëm në lidhje me trupin tuaj? Një vendim që mund të ishte shtyrë për më vonë? Një vendim me të cilin në moshën e pjekurisë ju mund të mos ishit të lumtur? Apo do të dëshironit që prindërit tuaj të prisnin e të kërkoni ndihmë dhe t'ju lejonin të rriteshit dhe të merrnit kohën e duhur për të kuptuar se si ndiheni me trupin tuaj?

I/e porsalinduri/a im/e është interseks. Çfarë ka të ngjarë të ndodhë në spital?

Nëse direkt pas lindjes zbulohet se fëmija juaj është interseks, përvoja juaj në ato momente ka të ngjarë të jetë e ndryshme nga shumica e prindërve:

- Menjëherë pas lindjes, apo pak kohë pas saj, fëmija juaj mund të mbahet larg jush për kohëzgjatje të ndryshme kohore. Gjithmonë pyesni se ku po dërgohet fëmija juaj, pse po mbahet larg jush, dhe kur do të kthehet përsëri tek ju. Kërkoni të shkoni me ta nëse është e mundur.
- Në vend të kontrolleve rutinore nga mjekët dhe ndërveprimeve me infermierë ose mamitë, me shumë mundësi do të takoni disa specialistë. Këta mund të jenë për shembull endokrinologë pediatrikë, kirurgë pediatrik ose specialistë të tjerë. Ju mund t'i takoni ata një nga një, ose në grup. Ka të ngjarë që në takim të ketë infermierë dhe persona të tjerë nga stafi mjekësor.
- Ka të ngjarë që të merrni ose shumë informacion të ri që është i vështirë për tu kuptuar ose të merrni kërkesa që lejojnë që teste të ndryshme mjekësore të kryhen mbi fëmijën tuaj. Pjesa më e madhe e informacionit që do të merrni do të jetë në një gjuhë komplekse mjekësore. Nëse ka ndonjë gjë që nuk e kuptoni, kërkoni sqarime më të qarta dhe pyetni nëse testet janë të nevojshme përpara se të pranoni.
- Ekipi mjekësor në spitalin tuaj mund të sugjerojë një larmi trajtimesh mjekësore, kirurgjikale dhe ndërhyrjesh të tjera. Këto përfshijnë gonadektomitë (heqja e indeve ovariane ose testikulare) dhe operacione të ndryshme gjenitale. Shtyni të gjitha operacionet që nuk janë shpëtuese për jetën dhe kërkoni këshilla dytësore.



Ka shumë trajtime eksperimentale që kryhen në spitale të ndryshme. Disa nga këto tashmë janë zbuluar se kanë efekte anësore shqetësuese afatgjata për shëndetin mendor dhe konjitiv. Këto përfshijnë administrimin e ilaçeve para lindjes, si dhe manipulimin e hormoneve të fëmijëve të vegjël përmes trajtimeve hormonale të administruara përmes injeksioneve ose xheleve.

- Nëse foshnja juaj për ndonjë arsye mbahet larg jush, kërkoni që t'ju kthehet menjëherë.
- Kërkoni që testimet të bëhen në praninë tuaj dhe pyesni arsyet e testeve përpara se të jepni pëlqimin tuaj. (Nëse, për ndonjë arsye, është i nevojshëm një test gjaku, do të jetë shumë më e lehtë për fëmijën që kjo të bëhet në praninë tuaj, të gatshëm për ta qetësuar atë.)
- Nëse është e mundur, telefononi një person të dashur ose të besueshëm dhe kërkoni atyre të qëndrojnë pranë jush. Kjo është një periudhë sprovuese për të gjithë prindërit e rinj dhe në krahasim me të tjerët, juve do t'u duhet të mbani më shumë shënime. Të kesh dikë aty për t'ju dhënë një dorë dhe për t'ju ndihmuar në mbajtjen e shënimeve mund të jetë shumë e dobishme. Pyesni nëse diskutimet mund të shtyhen derisa ky person të mbërrijë pranë jush.
- Shkruani dhe mbani sa më shumë shënime rreth informacionit që merrni. Regjistrimi zanor i bisedave tuaja do të thotë që nuk duhet të shqetësoheni aq shumë për marrjen e shënimeve me shkrim pasi shumica e telefonave sot vijnë me regjistruar zëri të integruar në to ose ka aplikacione që mund t'i shkarkoni lehtësisht. Në rast se jeni vetëm pas lindjes së fëmijës tuaj, regjistrimet mund të ofrojnë një alternative të vlefshme për një person të dytë kur më vonë kujtoni informacionin.
- Bëni pyetje, kërkoni shpjegime dhe kërkoni sqarime. Merrni kohën tuaj. Ju nuk mund të merrni vendime pa kuptuar mirë çdo gjë që ju thuhet. Ndonjëherë na duhet një kohë më e gjatë për të kuptuar koncepte dhe terminologji të reja dhe ju keni të drejtën absolute për të kuptuar se çfarë po ndodh.
- Pyesni se kur mund të shkoni në shtëpi. Për lidhjen tuaj me të porsalindurin/ën, shtëpia është një mjedis shumë më i mirë se një repart spitalor. Në shumicën e rasteve, duhet të jeni në gjendje të shkoni në shtëpi pak a shumë në një kornizë të ngjashme kohore si prindërit e tjerë. Nëse për ndonjë arsye, ky nuk është rasti, pyesni pse. Nëse ata po presin për rezultatet e ndonjë testi, pyetini nëse mund të shkoni në shtëpi dhe të vini përsëri kur rezultatet të dalin. Inisistoni të merrni përgjigje se pse nuk mund të shkoni në shtëpi.

Mjekët po më shtyjnë të marr një vendim shumë të shpejtë.

Çfarë duhet të bëjmë?

Menjëherë pas lindjes ju (dhe partneri juaj) ka të ngjarë të jeni të mbushur me emocione në kundërshtim me njëra-tjetrën. Për më tepër, lindja e fëmijëve shkakton ndryshime të rëndësishme në nivelet e hormoneve, duke ndikuar në mënyrën se si ndihemi. Edhe vetëm këta dy faktorë janë të mjaftueshëm për të treguar se kjo nuk është një kohë ideale për të marrë vendime të mëdha, e lëre më vendime që mund të ndikojnë rrënjësisht në të ardhmen e fëmijës suaj. Megjithatë, në disa raste, mjekët do të kërkojnë të ofrojnë kirurgji ose trajtim të menjëhershëm. Ndonjëherë ka nevojë për trajtim të menjëhershëm dhe këto do të diskutohen më tej në kapitullin tjetër. Ndërsa disa trajtime mjekësore janë të domosdoshme për shëndetin e fëmijës (shihni Marrjen e vendimeve në lidhje me ndërhyrjet mjekësore f. 14), shumica e trajtimeve nuk mund të racionalizohen vetëm në bazë të nevojës mjekësore, por bazohen në faktorë socialë dhe kozmetikë. Këto përfshijnë operacione që ndryshojnë pamjen e organeve gjenitale të jashtme të fëmijës suaj sepse ato nuk duken si organet gjenitale të shumicës së njerëzve, ose sepse në të këtyllë mënyrë fëmija juaj mund të kryejë një funksion gjinor të paracaktuar nga shoqëria, si për shembull të urinuarit në këmbë nëse fëmijës i është caktuar gjinia 'mashkull'. Këto gjithashtu përfshijnë operacione për të krijuar vagina në foshnje të caktuara femra në mënyrë që ata/o të përmbushin role të paracaktuara shoqërore. Këto trajtime janë me zgjedhje dhe fëmija juaj ka të drejtë t'i zgjedhë vetë ato kur të arrijnë pjekurinë e duhur për të marrë të këtyllat vendime. Ndërkohë, kërkoni mbështetje dhe drejtohuni pranë organizatave interseks, pasi ata mund të jenë në gjendje t'ju lidhin me prindër të tjerë që kanë përvoja të ngjashme. Mos harroni, fëmija juaj është një qenie autonome që mbështetet tek ju për mbrojtje, mbështetje dhe mbi të gjitha dashuri. Bekojni fëmijën tuaj me dashuri dhe shijojeni procesin e njohjes me të.

Dëgjo mendime të ndryshme rreth asaj që duhet të bëj me fëmijën tim.

Si mund ta di se cila është më e mira për të?

Çdo situatë është e ndryshme. Gjithmonë duhet të vendosni mirëqenien dhe shëndetin e fëmijës suaj të parën. Gjithashtu, mos harroni mirëqenien e vetes dhe familjes suaj. Eksploroni opsionet tuaja dhe bisedoni me njerëz me përvojë, duke përfshirë këtu të rriturit interseks. Jini kritikë ndaj këshillave që përqendrohen vetëm në ndryshimin fizik të fëmijës suaj. Mos lejoni që njerëzit t'ju shtyjnë të merrni vendime të shpejtuara. Shumica e vendimeve mund të shtyhen derisa fëmija juaj të jetë mjaftueshëm i pjekur për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Merrni kohë për të hulumtuar, kontaktoni advokues për të drejtat e personave interseks për mbështetje dhe përqendrohuni në procesin e njohjes me fëmijën tuaj të bukur të ri.

A nuk do të ishte më e lehtë për të gjithë ne që femija im të operohej ndërsa është akoma foshnje?

Edhe pse operacioni ose procedura të tjera mjekësore të kryera kur fëmija juaj është ende foshnje mund t'ju paraqiten si opsioni më i mirë, është e rëndësishme të dini se cilat mund të jenë pasojat afatgjata. Së pari, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm se kirurgjia e kryer nën anestezi të plotë është një akt që e vë jetën në rrezik. Sidomos kur bëhet fjalë në operacione që kryhen tek foshnjat dhe fëmijët e vegjël, por jo vetëm. Së dyti, ekziston mundësia që fëmija juaj interseks në shëndet të plotë, gjatë një operacioni që nuk ka për qëllim shpëtimin e jetës por vetëm "normalizimin" e trupit të tyre, të humbasë funksionalitetin e pjesës së trupit të operuar, siç është për shembull uretra. Nuk ekziston ende asnjë studim afatgjatë që flet për ruajtjen e funksionit erotik të përditshëm dhe të ardhshëm të organeve gjenitale që janë operuar në një moshë të re. Përkundër këtij fakti, shumë njerëz interseksualë që i janë nënshtruar operacioneve në fëmijëri kanë raportuar mpirje dhe dhimbje (për shkak të indit mbresë) dhe mungesë ose kufizim të ndjesisë erotike në të rritur. Së treti, ndërhyrjet mjekësore shpesh çojnë në ndërhyrje të mëtejshme që bëhen të domosdoshme dhe nganjëherë rezultojnë në varësi të përjetshme nga mjekët. Për më tepër, kërkime psikologjike kanë treguar që kujtimi ndaj dhimbjes është i zhvilluar që në foshnjëri dhe shpesh personat interseks mbi të cilët është operuar që në foshnjëri raportojnë se ndiejnë se diçka ishte bërë mbi trupat e tyre edhe pse nuk e kuptonim mirë se çfarë deri shumë me vonë në jetën e tyre. Se fundmi, normalizimi i ndërhyrjeve nuk e bën një trup interseks për në 'mashkull' ose 'femër', ato thjesht ndryshojnë pamjen e jashtme për t'i bërë ato trupa të duken/funksionojnë si të tilla në shkallë të ndryshme suksesi.

Nëse vendosim të mos lejojmë ndonjë ndërhyrje mjekësore ose operacion, trupi i fëmijës tim do të jetë plotësisht funksional?

Shumë njerëz interseksualë që nuk kanë kryer asnjë ndërhyrje kirurgjikale apo mjekësore kanë trupa përsosmërisht të shëndetshëm. Sipas disa studimeve që ekzistojnë, shumica e njerëzve interseksualë që i janë nënshtruar një operacioni normalizues, kanë një sërë problemesh shëndetësore që lidhen me këto trajtime. Në qoftë se nuk ekzistojnë rreziqe serioze për shëndetin, rekomandohet të prisni derisa fëmija juaj të jetë mjaftueshëm i pjekur për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes.

Si duhet ta regjistroj gjininë e fëmijës tim në certifikatën e lindjes së tyre?

Fakti që jetojmë në një shoqëri që, në pjesën më të madhe të saj, ende nuk e pranon me ligj diversitetin e sekseve njerëzore, do t'ju bëjë të ndiheni nën presion, që në shumicën e vendeve, ta regjistroni fëmijën si mashkull ose femër. Vende të ndryshme kanë rregullore të ndryshme në përsa i përket kohës dhe nëse shënjuesi i seksit në regjistrat zyrtarë vendoset pas pak ditësh ose edhe muajsh pas lindjes. Ju nuk duhet të ndiheni nën presion për të vendosur këtë shënjes të seksit para se kjo periudhë të mbarojë. Në vendet ku janë të disponueshme vetëm opsionet mashkullore ose femërore, organizatat interseksuale rekomandojnë që prindërit të caktojnë seksin siç e konsiderojnë ata më të përshtatshme, por të kuptojnë që ndërsa fëmija rritet, kjo gjë mund të duhet të ndryshojë në mënyrë që t'i përshtatet identitetit gjinor të fëmijës.

Në ç'gjinë duhet ta rris fëmijën tim?

Organizatat interseks rekomandojnë që ta rritni fëmijën tuaj si mashkull apo femër, pasi aktualisht kjo është mënyra se si strukturohen shoqëritë tona. Në të njëjtën kohë, duhet të keni parasysh që fëmija juaj mund të zhvillojë një gjini që nuk është në përputhje me seksin dhe gjininë që ju keni zgjedhur për të. Nuk ka asgjë të keqe me këtë – është thjesht fëmija juaj i/e cili/a, kur arrin në moshën e duhur për të shprehur personalitetin e tij/saj individual, zgjedh t'ju tregojnë se kush ata/o janë.



A konsiderohet interseks si një aftësi e kufizuar?

Të qenit interseks është një formë e larmisë trupore. Të qenit interseks nuk është as aftësi e kufizuar dhe as dëmtim fizik afatgjatë. Megjithatë, personat interseks që u janë nënshtruar operacionit dhe ndërhyrjeve të tjera mjekësore, për shkak të këtyre ndërhyrjeve shpesh kanë probleme shëndetësore që mund të cilësohen si aftësi të kufizuara.

A duhet t'i tregoj fëmijës tim që ai/ajo është interseks?

Po. Individët interseks të cilët tani janë tashmë adult dhe që janë rritur në turp dhe fshehtësi janë shumë qartë për mënyrën se si këto përvoja kanë ndikuar negativisht në jetën e tyre personale, në jetën e tyre familjare dhe në marrëdhëniet e tyre me prindërin/it ose kujdestarin/ët e tyre. Nga ana tjetër, familjet që kanë krijuar një kulturën e të folurit hapur me fëmijët e tyre për diversitetin e tyre trupor raportojnë se sa pozitivisht ka ndikuar kjo hapje në jetën e tyre familjare dhe vetëbesimin e fëmijës. Ju mund të zgjidhni shpjegime të përshtatshme për moshën. Gjëja më e rëndësishme është ta lini fëmijën tuaj të kuptojë se i doni atë pikërisht ashtu siç ai/ajo është.

A duhet t'u tregoj të tjerëve?

Vendimi për t'u thënë të tjerëve është një zgjedhje personale, por gjithashtu duhet të mendoni se si kjo mund të ndikojë tek fëmija juaj më vonë në jetë. Nuk është mirë për ju apo për fëmijën tuaj që të mos flisni për këtë gjë apo ta mbani sekret nga të gjithë. Si për çdo informacion tjetër personal, mendoni se kujt i besoni dhe kujt do të ishte e dobishme t'i tregoni. Në fakt, kur të vijë koha kur fëmija juaj do duhet të shkojë në çerdhe, kopsht apo shkollë deri në një farë shkalle do t'ju duhet ta ndani këtë informacion, në mënyrë që ai/ajo të mund të jetë të hapur me të tjerët përse i përket të qenit interseks. Kjo mund të jetë sfiduese, prandaj ju inkurajojmë të kërkon mbështetje për t'u kujdesur për mirëqenien tuaj. Megjithatë, shumë prindër që kanë zgjedhur ta ndajnë këtë informacion, kanë raportuar një ndikim pozitiv të rëndësishëm, i cili i ka ndihmuar ata t'i rrisin fëmijën e tyre në një mjedis të sigurt dhe fuqizues. Mos harroni, nuk është e nevojshme t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve, veçanërisht atyre që janë tepër private.

Marrja e vendimeve në lidhje me ndërhyrjet mjekësore

Pyetja e parë që duhet t'i bëni vetes është: Pse mendoj se fëmija im ka nevojë për ndërhyrje mjekësore?

A është sepse fëmija im po vuan nga një gjendje fizike që me të vërtetë kërcënon jetën e tyre? Më poshtë jepen disa shembuj të kushteve fizike kur trajtimi i menjëhershëm ose operacioni mund të jetë i nevojshëm, të ndjekura nga kushte kur ndërhyrja e menjëhershme nuk është e vërtetuar të jetë e nevojshme.

1. Kur mund të jetë e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme

Humbja e kripës

Humbja e kripës mund të ndodhë me një variacion trupor që quhet nga profesionistë mjekësore Congenital Adrenal Hyperplasia (CAH). Të dy, si fëmijët që janë shënjuar si mashkull, si fëmijët që janë shënjuar si femër mund vuajnë nga harxhimi i kripës. Ndërhyrja e menjëhershme mjekësore është e nevojshme për të zëvendësuar mineralet që mungojnë brenda fëmijës, por zakonisht pas kësaj ndërhyrjeje do të jenë jashtë rrezikut brenda 24 orëve. Gjithashtu, mund të jetë i nevojshëm monitorimi dhe mjekimi për të parandaluar incidentet në të ardhmen.

Uretra e mbyllur

Nëse fëmija juaj ka lindur me një uretër të mbyllur, urina nuk mund të largohet nga trupi. Në raste të tilla, operacioni i menjëhershëm mund të jetë i nevojshëm për të parandaluar helmimin e trupit të fëmijës tuaj.



2. Kur ndërhyrja e menjëhershme nuk ka të ngjarë të jetë e nevojshme

Heqje e indit gonadal

Ndonjëherë mjekët u thonë prindërve se indi gonadal (indi i të cilit bëhen testis dhe vezore) duhet të hiqet për të parandaluar kanceret e mundshme. Për shkak se operacioni për heqje të indit gonadal është kryer si ndërhyrje e standardizuar prej dekadash, nuk është mundur të verifikohet asnjëherë siç duhet përqindja e njerëzve interseks, të cilët u është zhvilluar kancer gonadal. Me fjalë të tjera, nuk ka mjaftueshëm njerëz interseks që nuk kanë kryer operacione gonadale për ta provuar një rrezik të tillë. Për të bërë një krahasim, rreziku i zhvillimit të kancerit të gjirit nuk do të thotë që mjekët si standard rekomandojnë të gjitha gratë t'u nënshtrohen mastektomive, por përkundrazi rekomandohet që të që bëhen kontrole rutinore për të monitoruar çdo shenjë të kancerit. Heqja e indit ovarian ose testikular të fëmijës tuaj gjithashtu u heq aftësinë fëmijëve për të kaluar një pubertet natyror. Për më tepër, nëse fëmijës i hiqen gonadet, në mënyrë që ai/ajo të hyjë në pubertet atëherë ai/ajo do të duhet t'i nënshtrohet terapisë së zëvendësimit të hormoneve. Kjo do të thotë vizita të rregullta te një mjek gjatë tërë adoleshencës së fëmijës suaj. Për arsye të ndryshme, disa të rinj nuk i përmbahen trajtimeve të tyre hormonale, gjë e cila mund të shkaktojë komplikime të mëtejshme. Hormonet janë jetike për shëndetin e kockave dhe mosmarrja e hormoneve pasi një gonadektomie ka një rrezik të lartë për të shkakuar osteopeninë ose osteoporozën – kushte në të cilat kockat e një personi bëhen të brishta. Shumë të rritur interseks, përfshirë këtu disa adoleshentë, raportojnë raste të osteopenisë dhe osteoporozës.

Kirurgjitë gjenitale

Të gjithë kemi pritshmëri të caktuara për mënyrën se si organet gjenitale femërore ose mashkullore duken, por rrallëherë kemi mundësinë të shohin larminë e gjerë të variacioneve që ekzistojnë. Në shumicën e shoqërive tona, ne jemi mësuar se organet gjenitale duhet mbajtur të fshehta, kështu që përshtypjet tona janë të kufizuara në ato që kemi parë në librat e biologjisë ose në media të ndryshme. Në shumë raste, organet gjenitale të bebeve dhe fëmijëve interseks operohen dhe ndryshohen kozmetikisht. Arsyet e dhëna për operacione të tilla përfshijnë dëshirën për t'i mundësuar adultit të ardhshëm për të:

- Përshtatur më mirë me shoqërinë dhe të rriteni si meshkuj apo femra
- Bërë një jetë seksuale të shëndetshme duke pasur organe gjenitale që funksionojnë në përputhje me pritshmëritë e shoqërisë
- Riprodhuar dhe për të pasur një familje

Disa njerëz interseks i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale si dhe ndërhyrje të llojeve të tjera që synojnë t'u garantojnë atyre mundësinë e mbetjes shtatzënë dhe riprodhimit. Shumë njerëz që u janë nënshtruar këtyre ndërhyrjeve gjatë fëmijërisë raportojnë se mendërisht dhe fizikisht, ata ndjejnë se trupi i tyre është dhunuar, madje duke e krahasuar këtë dhunë me abuzimin seksual. Ata gjithashtu raportojnë se ky trajtim u ka shkatërruar çdo dëshirë për të pasur marrëdhënie seksuale në moshë të rritur. Nga një këndvështrim tërësisht mjekësor, disa praktikues mjekësorë kanë ngritur zërin kundër ndërhyrjeve në moshë të re duke argumentuar se rezultatet fizike do të jenë shumë më të mira kur trupi është rritur dhe kur pacienti e ndjek trajtimin me vullnetin dhe dëshirën e tij.

Përfundime

Në raste të rralla, operacionet mund të jenë thelbësore dhe të pashmangshme, por ndodh shpesh që operacione jothelbësore të paraqiten si të tilla.

Sigurohuni që të merrni kohën e duhur dhe sa më shumë informacion të jetë e mundur para se të merrni një vendim që bie dakord më çfarëdolloj procedure mjekësore. Shumica e organizatave dhe aktivistëve interseks rekomandojnë fuqimisht që operacione, ndërhyrje jothelbësore ose normalizuese të mos bëhen para se individit të jetë i pjekur sa duhet për të marrë vetë një vendim të informuar. Kur fëmija juaj të jetë i pjekur mjaftueshëm, ai/ajo mund të marrë vendimin të kryejnë disa procedura mjekësore. Kjo është shumë herë më mirë se sa fëmija juaj të zbulojë se operacione janë kryer mbi trupin e tij/saj si foshnjë pa aprovimin e tij/saj.

Mjekët shpesh u thonë prindërve se moskryerja e operacioneve normalizuese ose mospërcaktimi i menjëhershëm i gjinisë së fëmijës së tyre do të shkaktojë probleme psikologjike. Sidoqoftë, nuk ekziston as edhe një provë apo fakt që e vërteton këtë qendrim. Një numër që sa vjen e rritet i personave interseks të cilët nuk kanë pasur asnjë ndërhyrje mjekësore deklarojnë se operacioni nuk është i nevojshëm dhe se ata po jetojnë një jetë të shëndetshme dhe të lumtur. Fatkeqësisht, dëmi psikologjik i kryerjes së operacioneve invazive dhe shpeshherë të dhimbshme në moshë të re është gjerësisht i dokumentuar nga persona interseks që u janë nënshtruar të këtilla ndërhyrjeve.

Nëse mjeku ju thotë se operacioni apo ndonjë ndërhyrje tjetër është e nevojshme, atëherë kërkojuni atyre:

- T'ju shpjegojnë në detaje se çfarë duhet bërë dhe pse
- T'ju përshkruajnë si rreziqet e marrjes së një vendimi në këtë fazë si rreziqet që vijnë nga të mosbërit asgjë
- T'ju thonë se ku mund të merrni më shumë informacion

Pas një takimi me një mjek i cili rekomandon ndërhyrje mjekësore:

- Referojuni një organizate interseks ose një grupi prindërisht të fëmijëve interseks për të marrë këshilla, informacion dhe mbështetje.
- Merrni ndihmë dhe gjeni një mjek që mund t'ju japë një mendim të dytë.
- Hulumtoni, rishikoni shënimet tuaja dhe sigurohuni që të kuptoni çdo gjë që u është thënë gjatë takimit.

Nëse fëmija juaj ose ju vendosni që ndërhyrja mjekësore është e nevojshme:

- Kërkoni nga mjeku t'ju shpjegojë me detajë se çfarë do të ndodhë.
- Kërkoni nga mjeku që t'ju tregojë nëse do të nevojiten ndërhyrje të mëtejshme dhe cilat janë rreziqet që lidhen me to.
- Nëse është e nevojshme, pyesni mjekun çfarë lloj mbështetjeje psikologjike ose të një lloji tjetër ka në dispozicion për ju dhe fëmijën tuaj.
- Kërkoni këshilla, informacion dhe mbështetje nga një organizatë interseks.

Një familje, e cila kishte emigruar në Evropë nga Amerika Latine, raportoi situatën e mëposhtme. Kur lindi fëmija i tyre, penisi i fëmijës së tyre nuk ishte aq i gjatë sa pritet zakonisht për një djalë. Mjeku e mori babanë mënjanë dhe i dha – sipas mendimit të tij – lajmin e keq. Ai gjithashtu i tha babait se fëmija i tij mund të vuajë nga një çrregullim i zhvillimit seksual dhe se për këtë çështje do të kryhej një diagnozë më e hollësishme. Mejku, duke supozuar se babai do të ishte personi më i dëshpëruar për sa i përket burrërisë së fëmijës së tij, u përpoq t'i propozojë një zgjidhje ngushëlluese duke i thënë babait se nëse ata do të dëshironin që organi gjenital mund të zvogëlohej më tej nëpërmjet operacionit dhe fëmija mund të rritej si vajzë. Reagimi i babait ishte krejt i ndryshëm nga sa pritej. Ai filloi t'i bërtasë mjekut, duke e ndaluar të vazhdojë më tej duke theksuar se, prej brezash, të gjithë burrat në familjen e tij kur kanë lindur kanë pasur këtë madhësi penisi dhe se të gjithë kanë pasur një jetë të lumtur bashkëshortore.

Të flasësh me fëmijën mbi të qenit interseks

Edhe pse është e rëndësishme të mos e bëni fëmijën tuaj të ndihet ndryshe në një aspekt negativ ose të mos shqetësohet për të qenit interseks, të mos flasësh fare për këtë temë mund të jetë po aq problematike.

Si dhe kur të flisni me fëmijën tuaj

Edhe pse mund t'ju duket si gjëja më e sigurt për t'u bërë, t'ia fshehësh faktin se është interseks deri në një moshë madhore mund t'i shokojë atë kur më në fund ta marrin vesh këtë gjë.

- Në mënyrë që fëmija juaj të jetë i përgatitur për të gjitha të rejtat që do të mësojë, mundohuni t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve që lindin në mënyrë të përshtatshme për moshën.
- Nuk keni pse t'i shpjegoni termat biologjike fëmijës suaj që në një moshë shumë e re, por gradualisht mund të filloni t'i prezantoni atë më idenë e larshmërisë duke u thënë përshtetshëm gjër si – “Jo të gjitha vajzat janë të njëjta.”
- Përgatiteni fëmijën tuaj për sfidat dhe vështirësitë që do të hasin gjatë rrugës, por sigurojini atë se do të jeni atje për ta mbështetur.
- Gjithashtu, në kohë veçanërisht të vështira kujtojeni atyre se të gjithë përballen me vështirësi dhe mërzitje ndërsa rriten.
- Kini parasysh se fëmija juaj do të rritet një ditë për të qenë plotësisht i/e pavarur, dhe se për të qenë në gjendje të marrin vendimet e tij/saj më vonë në jetë duhet t'i dijë të gjitha faktet që në moshë të herët.
- Gjithashtu, kini parasysh se sinqeriteti do t'ju ndihmojë të keni një lidhje të shëndetshme përgjatë, por edhe pas, viteve më të vështira, ato të adoleshencës. Mund të ketë vështirësi brenda familjes dhe dëme në marrëdhëniën tuaj nëse fëmija kupton se keni qënë të pasinqertë dhe të pandershëm me të. Për shumë të rinj interseks, është një përvojë traumatike që shkakton pasoja me besimin kur zbulojnë se pikërisht personat më pranë tyre janë ata që i kanë gënjyer. Fëmijët kanë të drejtë dhe meritojnë të dinë të vërtetën për veten e tyre.

Si të merremi dhe ta minimizojmë turpin

- Megjithëse mund të planifikoni mënyrën se si doni t'ia thoni fëmijës suaj dhe tjerëve se ai/ajo është interseks, kini kujdes që të mos e shndërroni këtë temë në një sekret (shih Bisedoni me të tjerët për fëmijën tuaj duke qenë interseks, f. 22). Nëse fëmija juaj mendon se kjo është diçka që duhet të fshihet nga të tjerët, kjo mund t'i bëjë ata të ndiejnë se ka diçka të gabuar ose të turpshme me të.
- Tregojani fëmijës suaj të gjitha faktet mbi trupat e tyre në një mënyrë pozitive, duke ia shpjeguar se të gjithë janë të ndryshëm, dhe se njerëzit mund të jenë të shëndetshëm dhe të lumtur pa qenë nevoja t'i përputhen një kategorie.
- Mundohuni të mos theksoni faktin se të qenit interseks është i rrallë ose jo e zakonshme, pasi kjo mund të shkaktojë ndjenja izolimi.
- Mendoni se cilat situata fëmija juaj do i përjetojë ndryshe nga të tjerët dhe mendoni se si t'i diskutoni ato në një mënyrë mbështetëse.
- Nëse fëmija juaj vendos të jetë i/e hapur dhe do të tregojë se janë interseks, mbështeteni. Edhe nëse vendosin se nuk është ende koha për ta bërë këtë gjë, mbështeteni.
- Mos e merrni për të mirëqenë identitetin gjinor të fëmijës suaj. Si për të gjithë fëmijët, identiteti i tyre gjinor ose orientimi seksual mund të jenë i ndryshëm nga ai që ju prisni.
- Shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm për larminë që ekziston në shoqëritë tona, e lëre më ekzistencën e njerëzve interseks. Ju duhet t'i përgatisni fëmijë tuaj për këtë fakt dhe ka shumë mjete në dispozicion për ta arritur këtë. Gjëja më e rëndësishme është të ndërtoni vetëbesim dhe ta bëni fëmijën tuaj të ndihet rehat me trupin e tyre, madje dhe krenar. Është gjithashtu e rëndësishme që fëmija juaj të dijë se ka prindër që e duan atë pikërisht ashtu siç janë dhe që gjithmonë do ta mbështesni atë.


Marrja e vendimeve

- Megjithëse mund të duket sikur marrja e vendimeve e masave në moshë të herët do të jetë gjëja më e mirë për fëmijën tuaj në plan afatgjatë, përvoja e shumë njerëzve interseks tregon të kundërtën. Ka të ngjarë që do të ketë rezultate pozitive nëse i përfshini fëmijët në marrjen e këtyre vendimeve apo nëse prisni deri kur ai/ajo të jetë i/e pjekur mjaftueshëm për t'i marrë këto vendime vetë. Që në moshën dyvjeçare fëmijët fillojnë të shprehin mendimet e tyre, kështu që ju duhet të përfshini fëmijën tuaj në vendimmarrje sa më shpejt të jetë e mundur.
- Sigurohuni që mjekët të mos ju bëjnë ju dhe fëmijën tuaj të ndihen të pafuqishëm. Kjo mund të ndodhë për shkak të terminologjisë mjekësore që ata përdorin, për shkak se ata janë ekspertët në këtë situatë, ose edhe sepse ata nuk kanë informacionin e duhur. Kur është e mundur, sillni me vete një mik apo anëtar të familjes të cilit ju dhe fëmija juaj i besoni në mënyrë që mund t'ju ndihmuar të ndihmojnë të diskutoni mundësitë dhe vendimet që do të merrni.
- Diskutoni të gjitha mundësitë me fëmijën tuaj, duke e lënë operacionin si opsionin e fundit (përveç rasteve kur ka implikime të menjëhershme shëndetësore).
- Ndani të gjitha informacionet në lidhje me rreziqet dhe rezultatet e mundshme në një mënyrë që i përshtatet moshës dhe botëkuptimit të fëmijës suaj.
- Jepini fëmijës suaj akses në të dhënat dhe historinë e tij/saj mjekësore. Është e drejta e tij/saj të kenë informacion mbi to.
- Përgjigjuni të gjitha pyetjeve të fëmijës suaj. Hulumtoni dhe gjithashtu fuqizojini atë të bëjë kërkimet e vetë mbi këtë temë. Mësoni veten por dhe atë se si të bëjnë një hulumtim të mirë mbi këtë çështje – si të identifikojë informacionin e vlefshëm dhe si të shmangë mosinformimin.
- Sigurojini se është pikërisht fëmija juaj ai/ajo që e kupton më mirë se të gjithë të tjerët se si ndihet për jetën dhe trupin e tij/saj, por edhe që ka ndihmë dhe mbështetje në dispozicion nëse ka nevojë.
- Përfshini fëmijën në bisedat tuaja me mjekët. Inkurajoni atë të bëjë pyetje dhe të rishikojë në mënyrë kritike këshillat dhe informacionet e dhëna.
- Fuqizoni fëmijën tuaj që të jenë ai/ajo që e ka kontrollin gjatë çdo ndërhyrje apo ekzaminimi mjekësor, dhe që të japë pëlqimi i tij/saj në çdo fazë. Hulumtoni dhe mësojuni të drejtat e fëmijës suaj si pacient.
- Kur bëhet fjalë për ekzaminimet mjekësore sigurohuni që profesionistët mjekësorë e përfshirë ta dinë që fëmija juaj është interseks.
- Duhet të jeni gjithmonë të pranishëm gjatë të gjitha ekzaminimeve mjekësore, përveç rasteve kur fëmija është i/e moshuar mjaftueshëm ose kur ai/ajo kërkon vetë që të jetë vetëm.

- Ekzaminimet mjekësore mund të jenë të frikshme, kështu që duhet t'i jepini fëmijës suaj kohën dhe hapësirën e duhur për t'u përgatitur e për to.
- Mbi të gjitha, besojini fëmijës suaj – ai/ajo është më i/e aftë për vendimmarrje të përgjegjshme nga sa mund ta mendoni.

Mbështetje

- Mos harroni se nuk jeni vetëm dhe se ju dhe fëmija juaj në fazë të ndryshme mund të keni nevojë për ndonjë mbështetje shtesë nga persona të tjerë.
- Lëroni fëmijën tuaj ta dijë që ka mundësi të ndryshme mbështetëse, duke përfshirë këtu grupe interseks, grupe këshillimi dhe terapie. Lëroni fëmijën tuaj të kuptojë se të kërkosht ndihmë kur ke nevojë nuk është një shenjë dobësie, por një hap pozitiv për të kujdesur veten.
- Nëse dëshiron, inkurajoni fëmijën tuaj të gjejë dhe t'u bashkohet grupeve mbështetëse. Lëroni atë të dijë se shkëmbimi i përvojave dhe historive jëtësore me njerëzit të tjerë interseks është një nga mënyrat më të mira për t'ndihmuar atë të kuptojë rezultatet e mundshme të vendimeve të tij/saj dhe të gjejnë një vend të sigurt për të eksploruar se çfarë do të thotë interseks. Të rinjtë që përdorin mediat sociale mund t'u drejtohen grupeve të mbështetjes online. Sidoqoftë, para se fëmija juaj të anëtarësohet në një grup mbështetës, bëni studimin tuaj për të siguruar se ato janë të miratuara nga një organizatë interseks.
- Si prind ose kujdestar, do të ketë raste kur ju do të keni nevojë për mbështetje shtesë. Megjithëse mund të mos ketë një grup specifik për prindërit e fëmijëve interseks në zonën tuaj, kërkoni grupe të tjera përkatëse prindërisht ose futuni në një grup në internet.



Si të bisedosh më të tjerë për fëmijën tuaj interseks

Aprovimi

Fëmijët fillojnë të shprehin mendimet e tyre rreth moshës dyvjeçare, kështu që ju duhet ta përfshihni fëmijën tuaj në vendimmarrje sa më shpejt që të jetë e mundur. Pyeteni se si do të ndihej nëse u tregoni të tjerëve se ai/ajo janë interseks. Kujtojeni atë se nuk ka asgjë për t'u turpëruar, por se doni të siguroheni që kur të ndihet i/e gatshëm t'u tregojë të tjerëve, ai/ajo ta kuptojë se çfarë me lloj reagimesh mund të përmballet dhe se si mund të merret me to. Është gjithashtu e rëndësishme të bien dakord se si duhet shpërndarë lajmi, se kush tjetër mund t'u thotë njerëzve mbi këtë gjë e se si duhet bërë kjo. Çdo informacion personal për një fëmijë apo të ri duhet trajtuar me kujdes, dhe ai/ajo duhet të ndihet gjithmonë nën kontroll se kush e di dhe se kur. Është gjithashtu e dobishme të diskutoni gjuhën dhe termat për të rënë dakord se çfarë fjalësh mund të përdoren dhe se si kjo u shpjgohet të tjerëve. Ju lutemi të keni parasysh gjithashtu se fëmija juaj mund të mendojë ndryshe rreth kësaj teme në fazave të ndryshme të jetës së tyre dhe se kjo bisedë duhet të rishikohet gjatë të gjitha momenteve të rëndësishme të jetës (fillimi i një shkollë të re, zhvendosja në një lagje / qytet të ri, bashkimi me një grup të ri).

Jini krenar

Kur flisni me të tjerët për fëmijën tuaj interseks, mos flisni sikur kjo të jetë një sekret apo diçka për të cilën duhet të keni turp. Megjithëse mund të merrni reagime negative ose të pakëndshme nga të tjerët, sa më shumë të jeni në gjendje të tregoni se nuk ka asgjë të keqe, aq më shumë njerëzit do të kuptojnë se problemi i vetëm janë paragjykimet e tyre ose mungesa e njohurive që kanë mbi këtë temë.

Sa më shumë të hapur dhe krenarë të jenë prindërit e fëmijëve interseks, aq më shumë vetëdije dhe mirëkuptim ka brenda shoqërive tona, gjë që është e dobishme për të gjithë.



Kini durim

Për njerëz të tjera, tema rreth të qenit interseks mund të jetë e re dhe në fillim ata mund të mos e kuptojnë. Merrni kohën tuaj për të shpjguar se çfarë do të thotë të jesh interseks. Shpjegoni se është e zakonshme dhe plotësisht e natyrshme. Jini të përgatitur për reagime dhe pyetje të papërshtatshme ose të çuditshme dhe përpuni të përgjigjeni me qetësi dhe pozitivitet. Shumica e njerëzve nuk e kanë me të keq, por thjesht nuk dijnë sesi të reagojnë për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit. Përdorni terma të thjesht dhe gjuhë të lehtë për t'u kuptuar. Në të njëjtën kohë, nuk është vetëm përgjegjësia juaj të edukoni të tjerët. Nëse dikush po bën shumë pyetje, thuaju atyre që ju akoma po mësoni, por se mund t'u dërgosh atyre burime për informacion të mëtejshëm nëse janë ende të interesuar.

Si të bisedosh me pjestarët e tjerë të familjes

Nëse keni fëmijë të tjerë, është e rëndësishme të bisedoni me ta se çfarë do të thotë të jesh interseks. Përmes bisedave të përgjithshme rreth dhe diversitetit dhe larmisë, gradualisht mund t'u tregoni se çfarë do të thotë të jesh interseks. Përveç se t'i mësosh fëmijës tuaj interseks se si t'i përgjigjet pozitivisht ngacmimeve ose bullizmit është po aq e rëndësishme t'u mësoni motrave dhe vëllezërve të bëjnë të njëjtën gjë, pasi ata gjithashtu mund të përjetojnë ngacmime për shkak të lidhjes familjare. Kur bëhet fjalë për anëtarët e moshuar të familjes mos supozoni se do të jetë domosdoshmërisht më e vështirë për të biseduar me ta. Për shembull, vlera të tilla si trajtimi i të gjithëve me respekt ose pranimi i asaj më të cilën jena na ballafaqon mund të përdoren si mënyra për të krijuar ura bashkëbisedimi me individë me besime më tradicionale. Edhe nëse përjetoni hezitim nga një anëtar i familjes për ta pranuar ose për të biseduar rreth fëmijës suaj interseks, jepni kohë personit dhe pyesni anëtarët e tjerë të familjes që tashmë e kanë pranuar t'ju ndihmojnë të flisni me ta. Inkurajoni ata të mësojnë më shumë rreth të qenit interseks përmes artikujve, dokumentarëve ose historive personale. Sa më shumë dinë për këtë temë, aq më shumë ka të ngjarë të bëhen pranues dhe mbështetës.

Bëhuni aleat

Nëse fëmija juaj ndihet rehat me këtë gjë, përpuni të rrisni ndërgjegjësimin për të drejtat e njerëzve interseks kudo që të keni mundësi. Gjeni mundësinë të flisni rreth temës interseks me grupe të ndryshme njerëzish ose postoni artikuj ose histori personale në faqet tuaja personale ne media sociale. Nëse njerëzit thonë diçka të pasaktë ose fyese për njerëzit interseks, përpuni t'i korrigjoni ata në një mënyrë të sjellshme dhe miqësore, por të vendosur. Një mundësi tjetër është që tu bashkoheni ose të mbështesni një organizatë interseks për të ndihmuar në rritjen e dukshmërisë në shoqëri dhe përparimin e të drejtave të personave interseks.

Pyetje që të tjerët mund të bëjnë

A është fëmija juaj vajzë apo djalë?

Se si do i përgjigjeni kësaj do të varet nga mënyra se si po rritni fëmijën tuaj. Nëse e rritni fëmijën si vajzë mund të thoni që është vajzë dhe nëse e rrisni si djalë mund të thoni që është djalë. Nëse e njihni mirë personin ose nëse ndiheni mjaftueshëm rehat me ta për ta bërë një gjë të tillë, mund t'u përgjigjeni se fëmija është interseks dhe se po e rrisni si vajzë apo djalë. Nëse po i rrisni pa përcaktuar gjininë e tyre në këtë pikë të jetës, mund të thoni që po i rritni në mënyrë neutrale, pa e përcaktuar gjininë.

Mos diçka shkoi keq?

Jo, është krejtësisht e natyrshme. Ndodh në të paktën 1 në 200 fëmijë dhe disa burime thonë se deri në 1.7% e fëmijëve mund të disa variacione të karakteristikave të seksit. Thjesht për këtë gjë nuk flitet gjerësisht në shoqëri.

A do të thotë kjo që fëmija juaj është një hermafrodit?

Jo. Hermafroditët kanë një set të plotë të organeve mashkullore dhe femërore, dhe kjo është e pamundur te njerëzit. Fëmija thjesht ka një variacion në karakteristikat e tyre seksuale, karakteristika të cilat nuk u konformohen normave mjekësore të organeve mashkull dhe femër.



A është një lloj aftësie e kufizuar ose çrregullimi?

Interseks është thjesht një shembull tjetër i diversitetit që gjendet tek njerëzit, që nuk është ndryshe nga diversiteti i ngjyrës së flokëve apo gjatësisë. Kthehet në paaftësi vetëm nëse i trajtoni njerëzit interseks ndryshe dhe nuk u jepni atyre të njëjtat shanse siç do të bënit me njerëzit jo-interseks.

Si duken organet gjenitale të fëmijës suaj?

Si t'u përgjigjeni personave që nuk i njohim: A nuk mendoni se kjo është një pyetje e çuditshme për t'u bërë? Nuk është aq e zakonshme t'i pyesim njerëzit se si duken organet gjenitale të dikujt. Edhe fëmijët e vegjël kanë të drejtën e privatësisë.

Si tu përgjigjeni anëtarëve të tjerë të familjes: Duken shumë mirë.

Si do të ndikojë teksa fëmija rritet?

Shumë fëmijë interseks do të rriten pa pasur nevojë për ndonjë ndërhyrje mjekësore apo ndonjë mbështetje të specializuar për sa kohë që ata/o janë të rrethuar nga njerëz që i duan dhe i pranojnë për ata/o ashtu siç janë. Të jesh i ndryshëm në çfarëdolloj mënyre, ka tendencën të çojë në raste më të larta të përballjes me ngacmime, bullizëm ose diskriminim, kështu që çështja kryesore është të sigurojmë që të ketë pranim dhe një mirëkuptim më të madh të njerëzve interseks në të gjitha fushat e jetës së fëmijës suaj.

A do të ndikojë ndaj kujt tërhiqen seksualisht?

Nuk ka asnjë lidhje midis karakteristikave të seksit dhe orientimit seksual, kështu që njerëzit interseks mund të jenë lezbike, gej, heteroseksual, biseksual ose ndonjë orientim tjetër seksual.

Personat interseks dhe identiteti gjinor

Shumë persona interseks identifikohen si femër ose mashkull dhe shpesh pajtohen edhe me shënjesin gjinor që u është caktuar gjatë lindjes. Ndonjëherë njerëzit interseks të cilëve u është caktuar gjinia gjatë lindjes, ndërsa rriten mund të kuptojnë se kjo nuk u përshatet. Kjo do të thotë se ndoshta do të duan të ndryshojnë emrin dhe mënyrën se si paraqiten për t'u përshatur më mirë me identitetin e tyre gjinor. Të tjerë mund të mos e identifikojnë veten si femër ose mashkull (identitet gjinor jo-binari) dhe mund t'i shprehin të dyja njëkohësisht ose asnjë nga aspektet e asaj që konsiderohet tradicionalisht femërore apo mashkullore. Dy persona interseks që ndajnë të njëjtat karakteristika seksuale mund të kenë identitete të ndryshme gjinore.

Si të flasim me mësuesit, doktorë dhe profesionistë të tjerë rreth fëmijës suaj interseks

Në pika të ndryshme në jetën e fëmijës suaj, do ju duhet të merrni vendime se cilët profesionistë do të duhet të dinë se fëmija juaj është interseks dhe se si i qaseni kësaj me të.

Është e rëndësishme të përfshini fëmijën tuaj në procesin e vendimmarrjes sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse pyeten për to në mënyrën e duhur, fëmijët, që një një moshë të herët, mund të shprehin mendimet dhe preferencat e tyre. Edhe pse fëmija juaj nuk do të jetë në gjendje t'i kuptojë të gjitha aspektet e vendimmarrjes që në një moshë shumë të re, është e rëndësishme që ai/ajo të fillojë të merret me aspektet që mund t'i kuptojë sapo të jetë në gjendje. Kjo do t'i fuqizojë atë dhe do t'i japë një ndjenjë më të fortë kontrolli mbi jetën e tij/saj. Në këtë kapitull, do të gjeni disa këshilla për planifikimin dhe bisedimin me mësuesit, mjekët, profesionistë dhe adultë të tjerë që do të jenë në kontakt me fëmijën tuaj.

1. Mjekët dhe personeli mjekësor

Profesionistët e parë me të cilët ju dhe fëmija juaj do të përfshihen në bisedime ka të ngjarë të jenë mjekët dhe stafi mjekësor. Marrja e vendimeve në lidhje me ndërhyrjet mjekësore është mbuluar tashmë (shiko f. 14), kështu që vijimi do të përqendrohet tek takimet dhe kontrollet periodike me mjekun.

- Kur zgjidhni një mjek për fëmijën tuaj, kontrolloni nëse ai është i informuar ose të paktën të hapur për të mësuar rreth personave interseks. Sigurohuni që të ndiheni rehat me të përpara se ta çoni fëmijën tuaj të regjistrohet dhe ta takojë atë. Nëse fëmija juaj është më i madh në moshë, inkurajojeni atë të jetë pjesë e procesit të shqyrtimit dhe përzgjedhjes, duke e lënë atë të vendosin nëse është mjeku i duhur për të.
- Bëni një listë me pyetje përpara takimit dhe për kujtesën tuaj mbani shënime gjatë takimit. Me lejen e mjekut, ju gjithashtu mund të dëshironi ta regjistroni bisedën në mënyrë që të mund t'i ktheheni përsëri asaj për ta dëgjuar që të mund të sqaroni pikat që nuk i keni kuptuar dhe aq mirë gjatë takimit. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë kërkoni të shkruajë për ju fjalët, termat apo frazat që nuk i kuptoni plotësisht.

- Gjithmonë këshillohuni me fëmijën tuaj nëse dëshiron që ju të të jeni me të në zyrën e mjekut apo jo. Në përgjithësi, prindërit janë gjithmonë të pranishëm përveç rasteve kur fëmija kërkon në mënyrë të qatë të kundërtën. Bëjeni të qartë se është fëmija juaj që po e kërkon diçka të tillë.
- Pyesni mjekët ku mund të gjeni më shumë informacion mbi biologjinë e caktuar të fëmijës suaj. Tregojini mjekut burimet që keni gjetur tashmë.
- Sigurohuni që të bëni kopje të shënimeve, dokumenteve dhe rezultateve të testeve mjekësore të fëmijës suaj.
- Jini atje me fëmijën tuaj dhe bëni çmos për të parandaluar teste apo vizita të panevojshme nga mjekët që nuk kanë nevojë të ekzaminojnë fëmijën tuaj.

Nëse një profesionist mjekësor ju rekomandon çfarëdoj operacioni, kërkoni atyre t'ju shpjegojnë nëse është i rëndësishëm për shëndetin fizik të fëmijës suaj apo nëse është thjesht "kozmetik" në natyrë. Mos bini dakord me përgjigje të paqarta si "është më mirë kështu", gjithmonë kërkoni informacion të qartë. Regjistrojeni informacionin ose mbani shënime. Gjithmonë kërkoni një mendim të dytë, mundohuni të lidheni me organizatat interseks ose me prindërit e fëmijëve interseks.

2. Mësues dhe stafi shkollor

Fëmijë të vegjël

Mund të mos ketë nevojë të diskutoni fare me stafin. Kjo varet nga fëmija juaj dhe situata juaj personale. Nëse fëmija juaj është i hapur për të folur për të qenit interseks dhe ka të ngjarë ta përmendë këtë në shkollë, atëherë është më mirë të flisni paraprakisht me mësuesin e tyre dhe drejtorin/en e çerdhës, kopshtit apo shkollës. Ju duhet të kontrolloni se çfarë dinë ata për të qenit interseks (ose ka më shumë të ngjarë që të jetë e nevojshme që t'u tregoni atyre se ku të gjejnë më shumë informacion), të diskutoni skenarë të mundshëm që mund të lindin dhe të bini dakord për mënyrën e trajtimit të tyre. Nëse fëmijës suaj nuk shkon ndërmend shpesh se janë interseks dhe për këtë arsye rrallë ose asnjëherë nuk e përmend këtë gjë, atëherë në këtë pikë mund të mos jetë e nevojshme ta informoni stafin shkollor.

Nëse fëmijës suaj i duhet të marrë ilaçe ose ka nevojë për lehtësira apo pajisje të veçanta për përdorimin e banjës, atëherë në dakordësi me stafin duhen marrë masa për ta mundësuar këtë. Kujtoni stafin e shkollës që fëmija juaj ka të drejtën e privatësisë, se çdo informacion i shpalosur duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale, dhe se ky informacioni duhet ndarë vetëm me persona për të cilët është e nevojshme ta dijnë. Informohuni mbi udhëzimet dhe rregulloret e vendosura mbi këtë çështje në zonat tuaja.

Fëmijë më të mëdhenj në moshë

Para se të fillojnë shkollën e mesme, bisedoni me fëmijën tuaj se si ai/ajo do të donte të menaxhohej situata. Në mënyrë që ai/ajo të mund të marrë një vendim të informuar, inkurajojeni fëmijën tuaj të mendojë për aspektet pozitive dhe negative të metodave të ndryshme dhe cilat mund të jenë disa nga pasojat e tyre. Nëse fëmija juaj vendos që plani më i mirë është një takim me shkollën ose institucionin edukues para se të fillojë vitin e ri shkollor, inkurajojeni atë që të përfshihen në takim dhe mbështetini në marrjen e një rol kryesor në diskutime duke planifikuar me të çeshtjet që duan të diskutojnë dhe të gjitha pyetjet që mund të lindin gjatë bisedës. Është mirë të pyesni shkollën se cilat janë rregullat e tyre për bullizmin dhe ngacmimet dhe diskutoni se si ata merren me incidente e lindura prej tyre. Është e dobishme të pyesni se si shkolla i mbështet nxënësit dhe cilat shërbime ose grupe janë vënë në dispozicion për ta.

Nëse fëmija juaj dëshiron të jetë i hapur mbi të qenit interseks, diskutoni mënyra të ndryshme të ngritjes së temës me stafin shkollor dhe dakordësohuni mbi mënyrat se si shkolla mund ta mbështesë fëmijën tuaj për ta bërë këtë në një mënyrë pozitive dhe e sigurt. Mendoni për mënyra që nuk e pengojnë (non-intrusive?) fëmijën tuaj më të cilat ju dhe stafi mund të kontrolloni për të siguruar që ai/ajo nuk po përjeton ndonjë pasojë negative prej të dalit hapur si person interseks.

Nëse fëmija juaj nuk dëshiron të zbulojë se është interseks ose zgjedh ta bëjë këtë vetëm me disa individë të besuar, bisedoni se si ta menaxhoni këtë dhe se si do të trajtohet situata nëse dikush e zbulon rastësisht.

3. Profesionistë të tjerë

Profesionistë të tjerë që mund të bëhen pjesë e jetës së fëmijës suaj mund të përfshijnë punonjës socialë, punonjës të rinisë, trajnerë sporti, udhëheqës fetarë ose psikologë. Dhënia e informacionit mbi fëmijën tuaj interseks ndjek në përgjithësi udhëzime të ngjashme si dhënia e informacionit për mësuesit. Merrni parasysh sa kohë kalon fëmija juaj me personin në fjalë dhe në çfarë konteksti. Në përgjithësi nuk ka nevojë të diskutoni që fëmija juaj është interseks me shumë prej profesionistëve të mësipërm përveç rasteve kur fëmija ka të ngjarë të nxisë vetë diskutimin ose kur ka dëshirë ta hapë këtë bisedë. Përveç kësaj, e vetmja arsye tjetër për të cilën mund të duhet të diskutohet është nëse ka ndonjë kërkesë specifike për fëmijën tuaj, siç është për shëmbull një strukturë private për ndërrimin e rrobave (dhomë zhveshjeje).

Nëse fëmija juaj ka nevojë të konsultohet me një psikolog ose një profesionist tjetër të shëndetit mendor, atëherë këshillohet që të diskutoni mbi këtë çështje me psikologun dhe fëmijën tuaj para takimit të tyre të parë. Jo të gjithë profesionistët e shëndetit mendor do të kenë njohuri mbi të qenit interseks, kështu që mund ndani me ta informacione ose udhëzime rreth trajtimit të temës. Kur diskutoni për këtë çështje, shikoni reagimin e personit. Shumica e profesionistëve do të jenë të lumtur për të mësuar diçka të re, por nëse personi reagon në një mënyrë që ju bën të ndihen të pasigurt, ose mund ta ngrini këtë si çështje me ta për të marrë më shumë siguri ose mund të kërkonin një praktikues tjetër. Gjithashtu, dëgjoni nga afër ndjenjat e fëmijës suaj mbi profesionistët me të cilët është në kontakt. Fëmijët zakonisht janë në gjendje të shprehin një mendim nëse duan të takohen me dikë ose jo që prej një një moshe shumë të re.

Nëse fëmija juaj shkon në vende të adhurimit të fesë, ju mund të dëshironi të bisedoni me individët përkatës. Përsëri, kjo do të varet nga situata juaj personale dhe marrëdhënia me besimin tuaj fetar. Ju mund të dëshironi të kërkonin ndihmë personalisht nga një udhëheqës brenda kongregacionit tuaj, ose fëmija juaj mund të ketë një individ të besueshëm që ai dëshiron ta informojë mbi të qenit interseks.

4. Përfundime

Në varësi të moshës dhe pjekurisë së fëmijës suaj, duhet të synoni ta përfshini atë në të gjitha këto biseda. Fëmijë shumë të vegjël mund të mos jenë në fazën e pjesëmarrjes së plotë në biseda, por është mirë t'i përfshini që prej fillimit për t'u dhënë atyre një zgjedhje mbi se sa duan të kontribuojnë. Nëse ata nuk janë të interesuar të jenë pjesë e bisedimeve ose i konsiderojnë ato të vështira ose të sikletshme, tregojuni se çfarë do të thoni gjatë takimit dhe pyetini nëse ata/o janë të kënaqur me mënyrën se si planifikoni t'i përfaqësoni. Gjithashtu, mbani mend se meqë ata/o mund të mos duan të përfshihen në diskutime tani kjo nuk do të thotë kjo mund të mos ndryshojë me kalimin e kohës. Gjithmonë jepuni atyre mundësinë për të marrë pjesë në bisedime pa i shtyrë ata ta bëjnë këtë pa dëshyrë e tyre.

Fjalorth

Kromozome

Një strukturë prej fijesh të gjata të holla acidesh nukleike dhe proteinash që gjenden në bërthamën e shumicës së qelizave të gjalla, e që mbajnë informacione gjenetike në formën e gjeneve.

Të zbulosh/ Të përhapësh

Të tregosh diçka personale në lidhje me veten tuaj ndaj një tjetri, siç është të qenit interseks.

ÇZhS ose (DZhS) – Çrregullime të Zhvillimit të Seksit (ose Diferenca të Zhvillimit të Seksit)


Termi ÇZhS ose DZhS u prezantua në vitin 2006 dhe që atëherë është përdorur nga profesionistë mjekësorë për t'iu referuar trupave interseks. Disa njerëz interseks i përdorin këto terma kur i referohen vetes. Një numër në rritje i personave interseks e konsiderojnë terminologjinë ÇZhS ose DZhS si stigmatizuese dhe preferojnë të përdorin termin intersex.

Diadike

Që përbëhet nga dy pjesë ose dy elemente, një ndarje binare.

Gjini

I referohet një konstrukti shoqëror që vendos pritshmëri kulturore dhe sociale mbi individë bazuar në seksin e caktuar në lindje.



Shprehje gjinore

I referohet manifestimit të njerëzve të identitetit të tyre gjinor tek të tjerët të tjerët, për shembull, veshja, të folurit dhe mënyrat e sjelljes. Shprehja gjinore mund ose jo të përputhet me identitetin/identitetet gjinore, ose me seksin që është caktuar gjatë lindjes.

Identiteti gjinor

I referohet përvojës thellësisht të ndjerë të brendshme dhe individuale të secilit person me gjininë e tyre. Kjo mund ose mund të mos korrespondojë me seksin e caktuar gjatë lindjes dhe përfshin sensin personal të trupit (që nëse zgjidhet në mënyrë të lirshme, ka të bëjë me modifikimin nëpërmjet ndërhyrjeve mjekësore, kirurgjikale etj., të pamjes ose funksionit trupor) dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë këtu veshjen, të folurit dhe mënyrat e sjelljes.

Identiteti gjinor i disa njerëzve bie jashtë sistemin gjinor binar normave që lidhen me to.

Organe gjenitale

Organet seksuale të një personi.

Gonadet

Testikujt, vezoret ose ovo-testikujt.

Hermafrodit

Një term i vjetër që është përdorur shpesh për të përshkruar personat interseks. Sot konsiderohet një term nënçmues.

Intereks

Një term që ka të bëjë me një serë tiparësh ose variacionesh fizike që qëndrojnë në mes të idealeve stereotipike për femrën dhe mashkullin. Njerëzit interseks lindin me karakteristika fizike, hormonale ose gjenetike që nuk janë as plotësisht femra, as plotësisht meshkuj; ose një kombinim i karakteristikave fizike, hormonale ose gjenetike që janë edhe femërore dhe mashkullore; ose që nuk janë as femërore dhe as meshkullore. Ekzistojnë shumë forma interseks; më shumë se një kategori e vetme është një spektër ose term ombrellë.

Kjo është arsyeja pse aktivistë interseks shpesh preferojnë të përdorin termin "karakteristika të seksit" (për shembull, kur flasim për bazat për mbrotjen nga diskriminimi). Nuk ekziston një gjendje statike e quajtur "statusi interseks", kështu që përdorimi i termit "karakteristikat të seksit" pasqyron faktin se të qenët interseks është një përvojë trupore dhe vetëm një prej pjesëve e identitetit të një personi.

LGBTQI

Një akronim për Lezbike, Gej, Biseksual, Transgjinator, Queer dhe Interseks.

Jo-binar

Një term i përdorur për të përshkruar njerëzit, identiteti gjinor i të cilëve bie jashtë ose ndërmjet kategorive tradicionale të femrës dhe mashkullit.

Seks

Kombinimi i karakteristikave trupore të një personi duke përfshirë këtu : kromozomet, hormonet, organet riprodhuese të brendshme dhe të jashtme dhe karakteristikat sekondare të seksit. Në shumicën e vendeve, kjo është ende e kufizuar në binari femër/mashkull, gjë që mund të përjashtojë njerëzit interseks.

Karakteristikat e seksit/Variacionet të karakteristikave të seksit

“Karakteristika të seksit” është një term që i referohet karakteristikave parësore të seksit të një personi, siç janë: kromozomet, anatomia, struktura hormonale dhe organet riprodhuese ose karakteristikat seksuale dytësore të një personi, të cilat bëhen të dukshme gjatë pubertetit, siç janë: gjinjtë, flokët e fytyrës dhe pubikë, molla e Adamit, shpërndarja e masës muskulore, gjatësia shtatit dhe shpërndarja e yndyrës. Prandaj, termi “variacione të karakteristikave të seksit”, shihet nga shumë aktivistë si një term më i saktë se “statusi interseksual”, pasi i referohet një spektri të karakteristikave të mundshme në vend të një statusi të vetëm homogjen ose përvojës së të qenët interseks.

Orientimi seksual

I referohet aftësisë të secilit person për dashuri të thellë, tërheqje emocionale dhe seksuale dhe marrëdhënie intime dhe seksuale me individë të një gjinie të ndryshme ose të së njëjtës gjini ose me më shumë se një gjini.

Trans

Është një term gjithëpërfshirës që i referohet personave, identiteti gjinor i të cilit dhe/ose shprehja gjinore ndryshojnë nga seksi/ gjinia që u është caktuar në lindje.

Mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: njerëz që identifikohen si transeksualë, transgjinatorë, transvestit, androgjenë, poligjenë (më shumë se një gjini), genderqueer, pa gjini, me gjini që ndryshon, jo-konform me gjininë, ose me ndonjë identitet dhe/ose shprehje tjetër gjinore që nuk përputhet me pritshmëritë shoqërore dhe kulturore të vendosura mbi identitetin gjinor.

Njerëzit interseks, në rastin kur refuzojnë seksin që u është caktuar gjatë lindjes, mund ose mund të mos identifikohen si trans.

Shumë nga përkufizimet e mësipërme janë dhënë me dashamirësi nga fjalori online i ILGA Europe.



Lidhje dhe burime të dobishme

Organizata Evropiane Interseks

OII Evropë

www.oiiurope.org www.intervisibility.eu

Të Rinj dhe Intersex

www.facebook.com/Youngandintersex European LGBTQI Organizatat

IGLYO

www.iglyo.com

ILGA Evropë

www.ilga-europe.org

Transgender Europe (TGEU)

www.tgeu.org

Organizatat Evropiane e Prindwrve

EPA

www.euparents.eu

Shoqata Evropiane për Fëmijët në Spital

www.each-for-sick-children.org

Burime dhe artikuj të dobishëm

Standing Up for the Human Rights of Intersex People

<https://oiiurope.org/standing-up-for-the-human-rights-of-intersex-people-how-can-you-help/>

<http://oiiurope.org/wp-content/uploads/2016/02/How-to-be-a-great-intersex-ally-A-toolkit-for-NGOs-and-decision-makers-December-2015.pdf>

European Parliament Resolution on the Rights of Intersex People (2019)

https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2019-0128_EN.html

Promoting the human rights of an eliminating discrimination against intersex people, resolution of the Parliamentary assembly of the Council of Europe

<https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=24232&lang=en>

Council of Europe report: Promoting the human rights of and eliminating discrimination against intersex people

<https://pace.coe.int/files/24232/pdf>

Council of Europe Paper: Human Rights and Intersex People

[https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CommDH/IssuePaper\(2015\)1&Language=lanEnglish](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CommDH/IssuePaper(2015)1&Language=lanEnglish)

Council of Europe: Resolution on Children's Rights to Physical Integrity

<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=20174>

United Nations Convention on the Rights of the Child

<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

Universal Declaration of Human Rights

<https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

EACH Charter

<https://www.each-for-sick-children.org/each-charter>



Rreth

IGLYO

www.iglyo.com

IGLYO – Organizata Ndërkombëtare Rinore Studentore Lesbike, Gej, Biseksual, Transgjisor, Queer & Interseks (LGBTQI) është rrjeti më i madh i të rinjve dhe studentëve LGBTQI në botë me mbi 90 organizata anëtare në 40+ vende evropiane.

Qëllimet e IGLYO janë:

- të edukojë aktivistë të rinj
- të rrisë vizibilitetin dhe të nxjerrë në pah larminë e identiteteve të të rinjve LGBTQI
- ta bëjë arsimin të sigurt dhe gjithëpërfshirës.
- zhvillojë dhe mbajnë një rrjet të angazhuar dhe të ndërlidhur të organizatave anëtare

IGLYO i arrin këto objektiva përmes një programi të gjerë trajnimesh dhe ngjarjesh ndërkombëtare, nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve online, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve, fushatave dhe tregimit të historive në mënyra dixhitale, dhe nëpërmjet projektit tonë arsimor gjithëpërfshirës LGBTQI.

IGLYO aisbl është regjistruar si një organizatë joqeveritare në Belgjikë (Nr. Ndërmarrje: 808808665).

OII Evropë

www.oieurope.org

OII Europe (Organizata Intersex Internacionale Evropë) është organizata ombrellë e organizatave evropiane për të drejtat e personave interseks me anëtare në të gjitha rajonet e Këshillit të Evropës. OII Europe u themelua në Ditën e të Drejtave të Njeriut, 10 Dhjetor, gjatë Forumit të Dytë Interseks në Stokholm në 2012.

OII Europe është një bashkëpunëtorë autonome e OII (Organizata Internationale des Intersexués), një rrjet global i decentralizuar i organizatave interseksuale, i cili u themelua në vitin 2003 dhe ka funksionuar që prej asaj kohe përmes grupeve të saj kombëtare në çdo rajon të botës.

Qëllimet e OII të Evropës janë:

- Implementimi i plotë të të drejtave të njeriut, integriteti trupor dhe vetëvendosjen e personave interseks.
- Ndalimi ligjor i trajtimit mjekësor dhe psikologjik jokonsensual dhe pa pëlqim të informuar dhe; mjekët ose profesionistët të tjerë nuk duhet të kryejnë asnjë trajtim me qëllim të modifikimit të karakteristikave të seksit, trajtime të cilat mund të shtyhen derisa personi që do të trajtohet të japë pëlqimin e informuar.
- Promovimi i vetëdijës, vizibilitetit dhe njohjes së personave interseks.
- Mbrojtja e plotë kundër diskriminimit dhe adoptimin e karakteristikave të seksit si bazë mbrojtëse.
- Edukimi i shoqërisë për çështje intersks nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

EPA

www.euparents.eu

EPA mbledh shoqatat e prindërve në Evropë të cilat së bashku përfaqësojnë më shumë se 150 milion prindër. EPA punon në partneritet për të përfaqësuar dhe për t'u dhënë prindërve një zë të fuqishëm në zhvillimin e politikave arsimore dhe vendimeve në nivelin evropian. Në fushën e arsimit, EPA synon të promovojë pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe njohjes së rolit të tyre qendror si përgjegjës primarë të edukimit të fëmijëve të tyre.

EPA mbështet pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e prindërve në shumë aspekte edukative:

- Duke mbledhur dhe shpërndarë informacionit me anë të botimeve të EPA, duke përfshirë këtu, gazeta, raporte seminarësh, uebfaqen e EPA, forume diskutimi.
- Theksimi i inovacionit në partneritetin arsimor dhe përhapja e informacionit në lidhje me praktika interesante dhe inovative arsimore.
- Promovimi i mbështetjes dhe trajnimit të vazhdueshëm të prindërve.
- Mbështetja e hulumtimit në të gjitha fushat në lidhje me pjesëmarrjen e prindërve në mjedisin arsimor.
- Bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në fushën e gjerë të arsimit.



Funded by



Government of
the Netherlands



This guide has been produced with the financial support of the Dutch Ministry of Education Culture & Science and the Rights Equality and Citizenship (REC) programme 2014-2020 of the European Union. The contents of this publication are the responsibility of IGLYO, OII Europe & EPA and can in no way be taken to reflect the views of the Dutch Ministry or the European Commission.